



ETAT DE FRIBOURG
STAAT FREIBURG

Shqip - Albanais



(Cours de langue et culture d'origine / Mësimi në Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut GJKA)

Mësimi në gjuhën e prejardhjes

Informacione për prindër dhe të gjithë me të drejtë edukimi

Mbështetja dhe nxitja e mësimi të gjuhës frënge dhe zhvillimi i kompetencave intelektuale të shumë gjuhëve është detyrë thelbësore e arsimit në shkollat publike. Zhvillimi i të mësuarit të shumë gjuhëve dhe kompetencave intelektuale janë gjithashtu qëllime të mësimi të gjuhës së prejardhjes (gjuha e prindërve HSK). Për këtë arsye ky mësim mbahet në shkollat publike dhe mbështetet nga autoritetet përgjegjëse për arsim të kantonit përkatës.

Shumëgjuhësia dhe kompetencat intelektuale

Të rinjët, të cilët zotërojnë njohuri të përgjithshme në gjuhën gjermane dhe flasin rjedhshëm në gjuhën e prindërve të tyre, zotërojnë një aftësi të rëndësishme për t'u integruar në profesion dhe shoqëri.

Mësimi i GJKA mbahet në të gjitha kantonet, në disa qytete mësimi ofrohet në më shumë se 25 gjuhë.

Qëllimet e mësimi të GJKA

Fëmijët dhe të rinjët

- i thellojnë dhe i zgjerojnë njohurit e tyre në gjuhën amtare (të parë), fitojnë më shumë kompetenca, kuptojnë më mirë në gjuhën e tyre, dhe janë në gjendje që të shkruajnë dhe lexojnë në gjuhën e tyre.
- zgjerojnë aftësit e tyre që të flasin në dy gjuhë, të njohin kulturën, vlerat e të tjerëve, t'i kuptojnë normat dhe ti respektojnë ato.

Përparësit në jetën shoqërore dhe profesionale

- Ai i cili zotëron gjuhën amtare, ka një bazë të mirë për të mësuar gjuhët e tjera.
- Njohurit e mira në gjuhën amtare i ndihmojnë fëmijët në ruajtjen e kontakteve familjare, me të afërmit dhe shtetin e tyre.
- Kontakti me shtetin amë është një kompetencë e mirë dhe e rëndësishme gjuhësore për gjuhën vendore (mundësia për shkollim të mëturshëm, punësim ose edhe rikthim në atdhe).

Prindërit mbështesin zhvillimin gjuhësor të fëmijut të tyre

- Nëse ata në shtëpi flasin në gjuhën amtare me fëmijët, nxisinë të mendojnë dhe ënderrojnë në këtë gjuhë, edhe kur fëmijët flasinë gjermanisht ose gjuhë të tjera me ta.
- Nëse shokët dhe shoqet e fëmijëve i nxisinë dhe mbështesinë, duke folur dhe dëgjuar për gjërat e jetës së përditëshme, duke biseduar, duke kënduar dhe duke u treguar tregime.
- Kur çdo pjesëtar i familjes në kontakt të drejtëpërdrejt me fëmijën flet në gjuhën amtare.

- Duke e motivuar fëmijun që të ketë kontakte me fëmijët e tjerë që flasin gjermanisht ose gjuhë të tjera.
- Duke e dëgjuar dhe lejuar fëmijun që të tregoj se çfarë ka mësuar në mësimin e GJKA dhe në shkollën publike.
- Duke u kujdesur dhe duke marrë kontakte me mësimdhënësit e GJKA dhe shkollës publike.

Organizimi

Kurset e mësimi të GJKA janë të organizuara nga ambasadat e vendeve të tyre ose nga persona privat. Mësimi organizohet varësisht nga grupet gjuhësore duke filluar nga viti i 1 ose i 2 i mësimi parashkollor.

Mësimi i GJKA zakonisht mbahet në klasa të shkollave publike sipas mundësive në afërsi të vendbanimit të fëmijut.

Mësimi i GJKA bazohet sipas orarit të shkollës publike (pushimet, dëftesa).

Nxënësi në fund të Semestrit të II do të marrë një Vërtetim që ka ndjekur kurset e mësimi të GJKA. Ky Vërtetim i bashkangjitet Dëftesës së shkollës publike.

Adresses de contact du canton

*Service de l'enseignement obligatoire de langue française (SEnOF), Route André-Piller 21, 1762 Givisiez, **Adrienne Berger**, Tel: 026 305 46 15, adrienne.berger@fr.ch*

*Amt für deutschsprachigen obligatorischen Unterricht (DOA), Mariahilfstrasse 2, 1712 Tafers, **Franziska Meier**, Tel: 026 305 40 90 franziska.meier@fr.ch
www.fr.ch/osso*